



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS SUDSKI SAVET KOSOVA KOSOVO JUDICIAL COUNCIL	01 / 398
NR. ET. NO	07.08.2023
DATA DT.	PRISHTINE - A

KGJK.nr.384/2023

Datë: 28 korrik 2023

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7, paragraf 1, pika 1.2, 1.4, 1.14, neni 25 të Ligjit 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe nenit 7, paragrafi 1, pika 1.5, neni 8, të Ligjit 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duke vendosur në çështjen ndaj z. Nikola Kabashiq, gjyqtar në Gjykatën e Apelit dhe Mbikëqyrës i Divizionit të Gjykatës së Apelit në Mitrovicë, në mbledhjen e mbajtur me 28 korrik 2023 merr këtë:

V E N D I M

I propozohet Presidentes së Republikës së Kosovës, shkarkimi nga pozita e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit, Divizioni në Mitrovicë, z. Nikola Kabashiq.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me datë 9 dhjetor 2022, ka pranuar nga kryetari i Gjykatës së Apelit z.Valon Totaj, kërkesën për fillimin e hetimit disiplinor për gjyqtarin e Gjykatës së Apelit, Divizioni në Mitrovicë, z.Nikola Kabashiq, duke pretenduar se i njëjti bazuar në lajmet e publikuara në portalin “Kallxo.com”, me titull “Zyrtarët e lartë të sistemit të drejtësisë, pjesëmarrës në takimin e Listes Serbe”, të shoqëruara edhe me fotografi, ku shihet qartë pjesëmarrja e z.Kabashiq në këtë takim politik, sipas Autoritetit Kompetent është në kundërshtim me Kushtetutën, Ligjit për Gjykata dhe Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar si dhe me nenin 5, paragrafi 2, pika 2.11 dhe 2.16 të Ligjit 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, që përcakton ndalimin e angazhimit në ndonjë aktiviteti që është në kundërshtim me detyrat e gjyqtarit.

Nga këto të gjetura, Autoriteti Kompetent i Gjykatës së Apelit ka kërkuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës themelimin e panelit hetimor, me qëllim të hetimit disiplinor.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 14 dhjetor 2022, ka themeluar panelin hetimor, i cili panel brenda afatit të përcaktuar me ligj ka zhvilluar hetime disiplinore, dhe raportin së bashku më provat e bashkangjitura i'a ka dorëzuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Me datë 18 maj 2023, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ka mbajtur seancë dëgjimore në të cilën ka marrë pjesë kryesuesi i panelit hetimor, ndërsa, subjekti i hetimit disiplinor edhe pse i ftuar në mënyrë të rregullt, ka refuzuar pjesëmarrjen në seancën dëgjimore të Këshillit, me arsyetimin se “nuk do të jem prezent në seancë dhe nuk do të pranoj asgjë, pasi jam gjyqtar në dorëheqje dhe po pres vendimin për miratim të dorëheqjes”.

Kryesuesi i panelit hetimor në seancën dëgjimore të Këshillit, deklaroi se si fakte të pa kontestuara nga ana e panelit hetimor ka qenë se gjyqtari Nikola Kabashiq me datë 5 nëntor 2022, ka marrë pjesë në takimin e organizuar nga Lista Serbe, në Mitrovicën e Veriut, dhe se subjekti i hetimit disiplinor me datë 6 nëntor 2022, i ka ofruar Këshillit dorëheqje me shkrim nga pozita e gjyqtarit të Republikës së Kosovës.

Subjekti i hetimit nuk ka marrë pjesë në seancën dëgjimore të Këshillit, mirëpo i njëjti në seancën dëgjimore të panelit hetimor, ka deklaruar se nuk ka qenë i sigurt a duhet të marrë pjesë në këtë seancë dëgjimore të panelit, pasi që ka dhënë dorëheqje me shkrim nga pozita e gjyqtarit dhe po pret vendimin për miratim të dorëheqjes. Më tutje, subjekti i hetimit disiplinor para panelit hetimor nuk e ka kontestuar pjesëmarrjen në takimin e datës 5 nëntor 2022, dhe sipas pretendimit të tij nuk ka qenë takim me karakter politik dhe se i njëjti Këshillit me 6 nëntor 2023, i ka ofruar dorëheqje nga pozita e gjyqtarit. Po ashtu, sipas subjektit të hetimit në këtë takim kanë qenë prezent edhe përfaqësues të Republikës së Kosovës, konkretisht nënkryetari i Qeverisë së Republikës së Kosovës z.Goran Rakiq, njëherësh edhe deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në fund ka deklaruar se çfarëdo vendimi që do t’u nxjerrë Këshilli lidhur me rastin disiplinor ndaj tij nuk do të ketë kuptim dhe nuk do të mund zbatohet sepse është gjyqtar në dorëheqje dhe se nga Këshilli i është ndërprerë edhe paga që nënkupton se çfarëdo sanksioni që do t’i shqiptohet nga Këshilli, nuk do të mund të zbatohet në praktikë.

Për të vërtetuar këtë çështje disiplinore Këshilli i administroj këto prova: Kërkesën për fillim të hetimit disiplinor të parashtruar nga Autoriteti Kompetent, të datës 9 dhjetor 2022; Email-i nga kryetari i Gjykatës së Apelit z.Valon Totaj për kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, i datës 10 nëntor 2022; Lajmi i publikuar në portalin “Kallxo.com” me titull “Zyrtarët e lartë të sistemit të drejtësisë nga komuniteti serb, pjesëmarrës në takimin e Listes Serbe”; Shënimi zyrtar i datës 24 prill 2023; dhe Fletëlëshimi me Epikrizë me numër 252, nga Qendra Klinike në Mitrovicë.

Email-i i evidentuar AGJ.nr.655/22, i kryetarit të Gjykatës së Apelit z.Valon Toaj, i datës 10 nëntor 2022, me të cilin është njoftuar Këshilli Gjyqësor i Kosovës për fillimin sipas detyrës zyrtare të inicimit të procedurës disiplinore për subjektin e hetimit.

Lajmi i publikuar në portalin “Kallxo.com” me titull “Zyrtarët e lartë të sistemit të drejtësisë nga komuniteti serb, pjesëmarrës në takimin e Listes Serbe, është publikimi i fotografive të takimit të Listes Serbe, në të cilin shihet subjekti i hetimit i ulur në rendin e parë në sallën në të cilën është mbajtur takimi i lartëcekuar.

Fletëlëshimi me Epikrizë me numër 252, nga Qendra Klinike në Mitrovicë, ku nga subjekti i hetimit arsyetohet mungesa në seancën dëgjimore të panelit hetimor.

Këshilli, pas shqyrtimit dhe analizimit të kësaj çështje, duke u bazuar në provat e lëndës më të cilat vërtetohet se z.Kabashiq, ka marrë pjesë në takimin e datës 5 nëntor 2022, takim ky i cili është paraqitur në të gjitha mediat e Kosovës, ku shihet qartë prezenca e tij përmes fotografive të

publikuara nga mediat, që nënkupton që subjekti i hetimit z.Kabashqi ka qenë në dijeni lidhur me organizimin dhe natyrën politike të këtij takimi, e cila pjesëmarrje është në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore dhe përbën shkelje të neni 5, paragrafi 2, nën-paragrafët 2.11 dhe 2.16 të Ligjit 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe me nenin 2. paragrafi 2.2.3 të Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Gjyqtar.

Në nenin 5, paragrafi 2, nën-paragrafët 2.11, dhe 2.16, të Ligjit 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, është parashikuar se shkelje e detyrave të gjyqtarit sipas këtij Ligji, përfshinë veprimet e mëposhtme, kur në mes tjerash janë përcaktuar edhe rastet kur gjyqtari: *“Kryen ndonjë funksion, detyrë ose shërbim, merr ndonjë përgjegjësi ose angazhohet me ndonjë aktivitet, kandidon ose zgjidhet në ndonjë funksion apo detyrë që është në kundërshtim me detyrat e gjyqtarit sipas kushtetutës, ligjit për gjykata dhe kodit të etikës profesionale për gjyqtarë”* ose *“anëtarësohet në ndonjë subjekt politik ose ndonjë organizatë tjetër politike, kërkon ose mban ndonjë post politik, kandidon ose zgjidhet në ndonjë post politik, apo angazhohet në ndonjë aktivitet politik”*.

Ndërsa, në nenin 2. paragrafi 2.2.3, pika b) të Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Gjyqtar është përcaktuar se *“gjyqtari nuk mund të marrë pjesë në tubime apo manifestime politike”*.

Veprimet e lartcekura të subjektit të hetimit janë në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në Ligjin 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe të Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Gjyqtar, dhe bien ndesh edhe me një mori parimesh të cilat janë të akceptuara në shumë dokumente ndërkombëtare, ku është parashikuar pavarësia dhe paanësia e gjyqtarëve në raport me çdo veprim që mund të përfaqëjë një mesazh që ka karakter politik dhe të marrë pjesë në veprimtari që organizohen nga subjektet politike përkatëse.

Bazuar në këto rregulla dhe parime, pjesëmarrja e subjektit të hetimit në aktivitete politike të organizuar nga “Lista Serbe”, ku subjekti i hetimit është njëri nga panelistet e takimit (*i ulur në radhën e organizatorëve respektivisht të drejtuesve të institucioneve*), konsiderohet mosrespektim i rëndë i detyrave të gjyqtarit dhe çënon rëndë besimin e publikut në paanësinë dhe pavarësinë e sistemit gjyqësor në përgjithësi dhe gjyqtarit përkatësisht subjektit të hetimit në përgjithësi.

Sipas vlerësimit të Këshillit, mos ndërmarrja e asnjë veprimi nga subjekti i hetimit disiplinor për t’a zbutur dëmin e shkaktuar si rezultat i cenimit të besueshmërisë së publikut në gjyqësor me pjesëmarrjen e takimit të datës 5 nëntor 2022, është përquar mesazh dekurajues për të tjerët.

Të drejtat e gjyqtarëve mund të mbrohen përmes mekanizmave të brendshëm të sistemit gjyqësor në kuptimin institucional apo sindikal dhe në asnjë mënyrë përmes bashkërendimit të aktiviteteve me parti politike, prandaj në këtë rast subjekti i hetimit si drejtues i divizionit të Gjykatës së Apelit në Mitrovicë, mban përgjegjësi të veçantë sa i përket pjesëmarrjes në këtë aktivitet.

Sa i përket pretendimit të subjektit të hetimit, se ndaj tij nuk mund të shqiptohen sanksione disiplinore se është gjyqtar në dorëheqje, sipas vlerësimit të Këshillit kjo nuk e liron nga përgjegjësia disiplinore, sepse bazuar në nenin 7, paragraf 3, të Ligjit 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, është përcaktuar se *“Vendimi për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarit lëshohet edhe në rastet kur pas fillimit të procedurave disiplinore gjyqtari ka lënë detyrën ose funksionin e cilit si gjyqtar është ndërprerë në ndonjë mënyrë tjetër”*.

Andaj, Këshilli në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 28 korrik 2023, duke u bazuar edhe në të lartëcekurat, në mënyrë unanime vendosi që t'i propozojë Presidentes së Republikës së Kosovës shkarkimin e z.Nikola Kabashiq, nga ushtrimi i funksionit të gjyqtarit në Gjykatën e Apelit, Divizioni në Mitrovicë.

Nga se u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KGJK.nr.384/2023, datë 28 korrik 2023

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Këshill juridike:

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese drejtëpërdrejtë në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij vendimi.

Kopje e vendimit i dërgohet:

- z. Valon Totaj, kryetar i Gjykatës së Apelit.
- Z. Nikola Kabashiq, gjyqtar në Gjykatën e Apelit, divizioni në Mitrovicë,